



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 19886 prot.

Shkodër, më 03.07. 2026

**VENDIM
Nr. 63, datë 29.07.2026**

**PËR NJË NDRYSHIM TË PJESSHËM NË VKB NR. 51 DATË 14.04.2009 “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE QË KËRKOHEN PËR TRANSFERIM NË PRONËSI TË BASHKISË
SHKODËR”, MIRATUAR ME VKM NR. 421 DATË 02.06.2010, TË NDRYSHUAR DHE
NDRYSHIMIN E FUSHËS SË PËRDORIMIT TË PRONËS ME NR.RENDOR 53
“SHKOLLA INDUSTRIALE DHE KONVIKT”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 29.07.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9, pika 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; në ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar; në ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 02.06.2010, “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës”, të ndryshuar; në certifikatën e pronësisë, datë 29.05.2025, si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e pjesshëm të VKB-së nr. 51, datë 14.04.2009, “Për miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër”, miratuar me VKM-në nr. 421, datë 02.06.2010, “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të

Shkodrës”, të ndryshuar, si dhe ndryshimin e fushës së përdorimit të pronës me nr. rendor inventarizimi 53, objekti “Shkolla Industriale dhe konvikt”, që ndodhet në Zonën Kadastrale 8592, si më poshtë:

Ishte: Emërtimi i objektit: “Shkolla Industriale dhe konvikt”

Fusha e përdorimit: Arsim parauniversitar

Nr. rend.	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës / adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Sip. totale: ndërtesë (m ²)	Funksion i për të cilin përdoret prona	Institucioni / enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / enti përdorues; statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shëni me të veçanta)
	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
13	8592 I-10	10/23	Truall, ndërtesë	Shkolla Industriale dhe Konvikt	14 976	4 684	Arsim	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër	

Bëhet: Emërtimi i objektit “Shkolla Industriale dhe Konvikt”

Fusha e përdorimit: Arsim, strehim social, shërbim social dhe shërbime administrative

Nr. rend.	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës / adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Sip. totale: ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni / enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / enti përdorues; statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shëni me të veçanta)
	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
13	8592 I-10	10/23	Ndërtesë, truall	Shkolla Industriale dhe Konvikt	13 966	4 069,6	Arsim, strehim social, shërbime sociale dhe administrative	Bashkia Shkodër	Bashkia Shkodër	

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miraturar me 31 vota

Vota Pro	31
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	30.07.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

